



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 3/637

Datë: 23 / 11 / 2016

Senati i UP-së, mbështetur në nenin 111 të statutit të UP, në mbledhjen e mbajtur me datë 17.11.2016 mori

V E N D I M

mbi afatet e provimeve dhe limitet e SEMS-it


1. Përveç tri afateve të rregullta: janar-shkurtit, qershorit dhe shtatorit të parapara me nenin 111 të statutit të UP, Senati i Universitetit lejon edhe dy afate të tjera: *afatin e nëntorit* dhe *afatin e prillit për vitin akademik 2016/17*.
2. Afati janar-shkurt, qershorit dhe shtatorit janë afate të rregullt. Në këto afate studentët nuk e kanë të limituar numrin e provimeve të cilëve ju nënshtrohen dhe mund të ju nevojitet për kusht.
3. Afati i nëntorit është afat plotësues. Në këtë afat studentët mund të paraqesin vetëm një provim. Provimet në afatin e nëntorit mbahen nën organizimin e njësive akademike të UP-së, gjatë javës së parë të dhjetorit. Provimi i dhënë në këtë afat nuk mund të llogaritet për kusht.
4. Afati i prillit është afat plotësues. Në këtë afat studentët mund të paraqesin vetëm një provim. Provimi në afatin e prillit mbahen nën organizimin e njësive akademike të UP-së, gjatë muajit prill në ditët e fundjavës.

Paraqitja e provimeve në çdo afat fillon jo më herët 6 javë para fillimit të provimeve dhe përfundon jo më vonë se 8 ditë para fillimit të afatit të provimeve.

Pas çdo afati të provimeve njësitë akademike raportojnë shërbimin e financave dhe prorektorin për buxhet dhe financa mbi vonesat eventuale të administrimit me regjistrimin e notave nga ana e stafit në afatet e përcaktuara.

Vendimi t'i dorëzohet:

1. Menaxhmentit të UP-së;
2. Sekretarit të përgjithshëm të UP-së;
3. Dekanëve të njësive akademike të UP-së;
4. Sekretarëve të njësive akademike;
5. Zyrtarit Ligjor të UP-së;
6. Arkivit të UP-së.



Prof. dr. Marjan Dema

Rektor i UP-së